



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:170947  
Datë: 22.02.2024  
Numri i dokumentit: 05362701

KPPP.nr. 1259/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Tie Meti Sh.P.K., me numër unik identifikues 810539950 dhe me seli në Konjuh, Lipjan, kundër debitorit “Pajtimi” L.L.C., me numër unik identifikues 810125535 dhe me seli në Malishevë, rr. “Adem Jashari”, p.n., me pronar B.M., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1052/2023 të datës 05.07.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka nga Prishtina, jashtë seancës me datën 22.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Pajtimi” L.L.C., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 1052/2023 i datës 05.07.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, **MBETET NË FUQI.**

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Tie Meti Sh.P.K., me datë 05.07.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 1052/2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 20-SHV01-001-5153, e datës 13.07.2020 dhe Faturës nr. 22-SHV01-001-5603, e datës 11.07.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,338.28 EUR (me shkronja: dymijë e treqind e tridhjetë e tetë euro e njëzet e tetë euro cent) me kamatë ligjore prej 8% duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor, me arsyetimin se faturat i takojnë vitit 2020 dhe të njëjtat janë vjetërsuar, si dhe kreditori me debitorin kanë pasur raporte të mira, andaj kërkesa për përmbartim është një kërkesë e ngutshme. Duke qenë se debitori ka shprehur gatishmëri që të paguajë faturat, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ashtu që urdhrin përmbartimor ta anulojë në tërësi.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 20-SHV01-001-5153, e datës 13.07.2020 dhe Fatura nr. 22-SHV01-001-5603, e datës 11.07.2022, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shumata e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e vënë në secilën faturë, dhe të njëjtat i është bashkëngjitur propozimit për përmbartim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbartimit.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit se në rastin konkret kemi të bëjmë me vjetërsim të borxhit por që ky pretendim rezulton të jetë i pabazuar për faktin se fatura nr. 20-SHV01-001-5153 është bërë e arritshme me datë 13.07.2020, kurse fatura nr. 22-SHV01-001-5603 është bërë e arritshme me datë 11.07.2022, ndërsa propozimi për përmbaram është paraqitur me datë 05.07.2023, pra pa kaluar afati tre (3) vjeçar i parashkrimit i përcaktuar me nenin 355 të Ligjit për Marrdhëniet e Detyrimeve i cili parashihet se “*Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite*”.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim mirëpo gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për të vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaramit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1259/23, datë 22.02.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.